



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2024:173719

Datë: 01.08.2024

Numri i dokumentit: 06007712

P.nr.134/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhafer, në çështjen penale kundër të pandehurit A.S. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.1174/23, e datës 18.06.2024, më datë 01.08.2024 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1174/23, e datës 18.06.2024, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI: A.S., nga i ati R..., e ëma A..., e vajzërisë I..., i lindur më ..., në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, me vendbanim në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, me numër personal ..., me profesion vullkanizer, i pamartuar, i papunësuar, me gjendje të mesme ekonomike, e ka të përfunduar shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datën 10.08.2022, rreth orës 19:38, në rrugën ... në Vushtrri, i pandehuri pa autorizim ka poseduar substanca apo preparate, të cilat me ligj janë shpallur si narkotikë, në atë mënyrë që me rastin e ndaljes dhe kontrollit nga ana e zyrtarëve policor, tek i njëjti është gjetur dhe sekuestruar një sasi e substancës narkotike e cila pas matjes dhe ekzaminimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, ka rezultuar të jetë e llojit marihuanë me peshë të përgjithshme prej 1.43 gram.

- Me këtë ka kryer veprën penale *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge* nga 269 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70, dhe nenit 269 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 449, dhe 495 të KPPK-së,

GJ Y K O N

TË PANDEHURIT: A.S. i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej katërqind (400) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Urdhërohet konfiskimi i substancës narkotike e llojit marihuanë-kanabis e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC) në peshë prej 1.43 gram.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP-II.nr.1174/23, e datës 18.06.2024 kundër të pandehurit të pandehurit A.S. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të akuzuarit të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri A.S., ligjvënësi ka paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në një (1) vit, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës: Raport i oficerit, i datës 10.08.2022, Raport policor, i datës 10.08.2022, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin A.S., i datës 10.08.2022, Procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitarin E.B., i datës 10.08.2022, Memorandum zyrtar, i datës 11.08.2022, Raport i shpejtë me numër të rastit 2022-BD-736, i datës 10.08.2022, Lista e dëshmimeve nga njësia e forenzikës, i datës 10.08.2022, Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i datës 10.08.2022, Fotoalbumi i përbërë prej pesë (5) fotografi, Raport të ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, i datës 30.11.2022, janë prova të besueshme të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprës penale *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par.2 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata mori parasysh si rrethanë lehtësuese: bashkëpunimin vullnetar të të pandehurit, ashtu që i njëjti e ka pranuar kryerjen e veprës penale qysh në dhënien e deklaratës në polici. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh

shkallën e përgjegjesisë penale, dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështtrim me nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Urdhrin për konfiskimin e substancës narkotike, gjykata e ka marrë konform nenit 269 par.3 të KPRK-së, ku është përcaktuar se “*Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen*”. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.134/24, datë 01.08.2024

Zyrtarja ligjore
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.